# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-441303**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Gjesti dënohet me 2 vjet burgim me kusht dhe 6 mijë euro gjobë |
| ADRESA | `https://www.koha.net/kronike/gjesti-denohet-me-2-vjet-burgim-me-kusht-dhe-6-mije-euro-gjobe` |
| BURIMI | koha.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 19:43:12 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 7 shtator 2026, 14:57:49 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f1ac27b3dbfd64a452ff3f925ba139eea4efa3d1cb60e09e21810f50faa86807` |
| TEKSTI | `0a6d56693200d74d2ffb71d24e8a260b1b2ce3b0b8947de6b8f6c809e98feea9` |
| PAMJA | `664c414ee14093251482e92e31156dfddbf96475214b944992a71ae31ca71db3` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `86abce3092900207656c4c40551b2d36f1818c5a854343c1f5c06eaca0a3d0e3` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/86abce3092900207656c4c40551b2d36f1818c5a854343c1f5c06eaca0a3d0e3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën Kontribuo → Letër lexuesit

KRONIKË

# Gjesti dënohet me 2 vjet burgim me kusht dhe 6 mijë euro gjobë



7 shtator 2026 16:57

Shpërndaje në:

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Gjykata Themelore në Prishtinë, pas aprovimit të marrëveshjes për pranim fajësie, e ka dënuar me 2 vjet burgim me kusht dhe 6 mijë euro gjobë këngëtarin Besart Kelmendi i njohur si Gjesti, lidhur me akuzën për tri vepra penale "Armëmbajtje pa leje", "Kanosje" dhe "Asgjësim apo dëmtim i pasurisë". Aktgjykimi u shpall të hënën nga gjykatësja Edita Çanta, raporton "Betimi për Drejtësi".

Për veprën penale "Kanosje", i akuzuari u dënua me 2 vjet burgim me kusht, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale brenda dy vjetëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Për veprën penale "Asgjësim apo dëmtim i pasurisë", u dënua me 3 mijë euro gjobë. Kurse, për armëmbajtje pa leje, u dënua me 3 mijë euro gjobë.

Ndaj Gjestit, Gjykata shpalli dënim unik me 2 vjet burgim me kusht dhe 6 mijë euro gjobë.

Në dënimin me gjobë, i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim.

I akuzuari obligohet t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë për paushallin gjyqësor 50 euro dhe 20 euro të tjera për Fondin për Kompensimin e Krimit.

Pala e dëmtuar u udhëzua në kontest të rregullt juridiko-civil. Ndaj këtij vendimi, palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh pas pranimit të aktgjykimit.

Edhe



Kronikë • 23 kor 2026
Gjesti në Shqipëri, dështon seanca ku akuzohet për tri vepra penale

Ndryshe, Prokuroria Themelore në Prishtinë më 19 mars 2026 njoftoi se këngëtari Besart Kelmendi i njohur si Gjesti, ka arritur marrëveshje për pranim fajësie me Prokurorinë, andaj me kërkesë të prokurorit, atij iu ndërpre masa e paraburgimit.

Arbëri.
14 shkolla në proces të mbylljes, shkaku i rënies së numrit të nxënësve

Kronikë.
Vëzhgimi me dronë, Policia në Gjakovë për 5 ditë pezulloi 152 patentë shoferë dhe shqiptoi 774 gjoba

Arbëri.
Çitaku: Kushtetuta nuk është meny prej së cilës zgjedh çka të pëlqen

Futboll.
Galtasaray fiton me rezultat minimal në shtëpi

Shtojca për Kulturë.
Xhafa: Rezistenca e popullit shqiptar – burim i pashtershëm frymëzimi

Futboll.
Krasniqi asiston dy herë në fitoren 5:0 të Amedsporit

Gjesti ishte arrestuar më 11 mars, ku akuzohej për tri vepra penale. Ai më 19 mars kishte pranuar fajësinë dhe ishte liruar nga paraburgimi.

#GJESTI #BESART KELMENDI

## Artikuj të ngjashëm



Kronikë • 13 mar 2026

Një muaj paraburgim për Gjestin



Kronikë • 11 mar 2026

Gjesti ndalohet për 48 orë, dyshohet për tri vepra penale



Showbiz • 19 mar 2026

Gjesti pranon fajësinë, lirohet nga paraburgimi



Kronikë • 11 mar 2026

Arrestohet Gjesti, dyshohet për armëmbajtje pa leje

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

+383 (0) 38 249 105 / [email protected]

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Download on the App Store | GET IT ON Google Play

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.